

V E N D I M
Nr.309, datë 15.5.2003

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË ALBKROMIT SHA,
QË SHKURTOHEN NGA PRIVATIZIMI DHE DHËNIA ME KONCESION E
INDUSTRIË SË KROMIT**

(Ndryshuar me VKM nr.853, datë 19.12.2003)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Albkrom” dhe të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësve të administratës së Albkromit sh.a., *të cilët shkurtohen deri në fund të vitit 2004*, si rezultat i privatizimit dhe dhënies me koncesion të industrisë së kromit, t’u jepet një shpërblim, për dy vjet, i barabartë me pagën bazë mesatare mujore të vendit të punës që kanë marrë gjatë vitit 2002. Fondet e nevojshme të sigurohen nga të ardhurat që dalin nga privatizimi i objekteve të Albkromit sh.a *dhe të ardhurat e tjera, që sigurohen nga veprimtaria e shoqërisë, gjatë likuidimit.*

2. Shpërblimin, sipas pikës 1 të këtij vendimi, e përfitojnë punonjësit e Albkromit sh.a., të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune me këtë shoqëri për më shumë se një vit. Me fillimin e punës punonjësit i ndërpritet shpërblimi.

3. Ky shpërblim të bëhet me 8 këste, ku secili këst përfshin 3 muaj. Pagesa e shpërblimit fillon nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me Albkrom sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano